



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 420

Lënda: Kërkimi shkencor në Infermieristikë

PROGRAMI I LËNDËS								
Kërkimi shkencor në Infermieristikë								
Titullari i lëndës:		Aurela Saliaj <i>Prof.asoc. PhD në Pediatri</i> _____						
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Lab	Praktikë	Projekt klinik		
	5	30	15	0	10	5	65	125
Tipologjia e lëndës		Lëndë bazë e programit						
Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri II						
Lloji i lëndës		E detyruar						
Programi i studimit		Master Profesional në Infermieri Patologjike						
Kodi i lëndës		INF 420						
Adresa elektronike e titullarit / pedagogut të lëndës		aurela.dai@univlora.edu.al						

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	<p>Epidemiologjia: Ky modul studion adresimin e çështjeve të tilla si rritja apo ulja e sëmundjeve të ndryshme në periudha të ndryshme kohore, në popullata të ndryshme, si dhe në subjekte të ndryshme brenda të njëjtës popullatë.</p> <p>Metodologjia e kërkimit shkencor në Infermieri: Në këtë modul trajtohen teknikat dhe metodat bazë me të cilat operohet në fushën e kërkimit shkencor dhe specifikat e studimeve shkencore infermierore.</p>
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">☞ Njohja e studentëve me metodikën e studimeve epidemiologjike në komunitet dhe klinikë.☞ Njohja me tipet e hulumtimeve shkencore dhe planifikimin e tyre.☞ Prezantimi i teknikave të shkrimit të raporteve shkencore.☞ Njohja me modelet e aplikimit të projekt-propozimeve.
Rezultatet e pritshme	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none">☞ Të hartojnë dhe zbatojnë një kërkim shkencor klinik dhe komunitar.☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të studimeve shkencore infermieristike.☞ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e infermieristikës.☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

KONCEPTET THEMELORE

- Epidemiologjia është shkencë që studion shpeshësinë, shpërndarjen dhe faktorët përcaktues të sëmundjeve në popullatat njerëzore.
- Madhësitë e shpeshësisë së sëmundjes më të përdorshme në praktikë janë incidenca dhe prevalenca.
- Etapat e studimit shkencor në infermieristikë përfshijnë: përcaktimin e fushës së studimit, studimin e literaturës, përcaktimin e qëllimit, objektivave dhe hipotezave të studimit, planifikimin e studimit, kryerjen e një studimi pilot, mbledhjen e të dhënave në popullatë, analizimin e të dhënave, konkluzionet dhe rekomandimet, shkrimin e raportit shkencor mbi studimin e kryer.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	Kapitulli I: Epidemiologjia Tema 1 - Hyrje në Epidemiologji. <i>Përkufizimi i Epidemiologjisë. Faktorët që ndikojnë sëmundshmëritë e popullatave.</i> Tema 2 - Disa koncepte epidemiologjike mbi sëmundjen. <i>Mënyrat e transmetimit të sëmundjeve infektive në popullatë. Llojet e parandalimit në shëndetin publik.</i> Seminar 1 - Shoqërimet statistikore.	⁽¹⁾ fq.9-22 ⁽¹⁾ fq.41-54	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
II.	Tema 3 - Disa konsiderata etike në Epidemiologji. <i>Detyrimet ndaj pjesëmarrësve në studim. Privatësia dhe konfidencialiteti. Konflikti i interesit.</i> Tema 4 - Madhësitë e shpeshësisë së sëmundjes <i>Përkufizimi dhe llogaritja e Incidencës dhe Prevalencës.</i> Seminar 2 - Madhësitë e shpeshësisë së sëmundjes.	⁽¹⁾ fq.260-270 ⁽¹⁾ fq.76-86	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
III.	Tema 5 - Studimet kohort. <i>Përkufizimi dhe organizimi i studimeve kohort. Avantazhet dhe disavantazhet.</i> Tema 6 - Studimet rast-kontroll. <i>Përkufizimi dhe organizimi i studimeve rast-kontroll. Avantazhet dhe disavantazhet.</i> Seminar 3 - Studimet kohort dhe rast-kontroll.	⁽¹⁾ fq.87-94 ⁽¹⁾ fq.95-123	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
IV.	Tema 7 - Studimet transversale. <i>Përkufizimi dhe organizimi i studimeve transversale. Avantazhet dhe disavantazhet.</i> Tema 8 - Studimet eksperimentale. <i>Përkufizimi dhe organizimi i studimeve eksperimentale. Randomizimi.</i> Seminar 4 - Studimet transversale dhe eksperimentale.	⁽¹⁾ fq.124-128 ⁽¹⁾ fq.129-164	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
V.	<p>Tema 9 - Vlerësimi i rrezikut për zhvillimin e sëmundjes. <i>Llogaritja e Gjasave dhe Riskut të zhvillimit të sëmundjes.</i></p> <p>Tema 10 - Përmbledhje e organizimit të studimeve epidemiologjike. <i>Organizimi diferencial i studimeve epidemiologjike.</i></p> <p>Seminar 5 - Vlerësimi i rrezikut për zhvillimin e sëmundjes.</p>	⁽¹⁾ fq.165-176	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
VI.	<p>Kapitulli II: Metodatat e kërkimit në Infermieristikë</p> <p>Tema 11 - Organizimi i studimit. <i>Metodologjia e organizimit të studimit shkencor.</i></p> <p>Tema 12 - Etapat paraprake të hetimit shkencor. Studimi i literaturës <i>Kriteret e përzgjedhjes së literaturës që do të përfshihet në prezantimin e studimit. Burimet parësore dhe dytësore të informacionit. Rregullat e shkrimit të referencave.</i></p> <p>Seminar 6 - Studimet review.</p>	⁽²⁾ fq.13-36 ⁽²⁾ fq.37-38	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
II.	<p>Tema 13 - Titulli, qëllimi dhe objektivat e studimeve shkencore <i>Qëllimi i studimit dhe formulimi i titullit. Objektivat e studimit. Formulimi i hipotezës.</i></p> <p>Tema 14 - Planifikimi i studimit shkencor. Popullatat dhe marrja e mostrave në studim <i>Karakteristikat e popullatës së studimit. Llojet e mostrave.</i></p> <p>Seminar 7 - Ngritja e hipotezave.</p>	⁽²⁾ fq.38-46 ⁽²⁾ fq.47-78	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
I.	<p>Tema 15 - Ndryshorët. <i>Klasifikimi dhe përkufizimi i ndryshorëve.</i></p> <p>Tema 16 - Metodatat e mbledhjes së të dhënave. <i>Burimet e informacionit për ndryshorët e përfshirë në studim.</i></p> <p>Seminar 8 - Ndryshorët dhe metodatat e mbledhjes së të dhënave</p>	⁽²⁾ fq.79-88 ⁽²⁾ fq.88-97	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
IX.	<p>Tema 17 - Intervistat, pyetësorët e vet-administruar dhe pre-testet <i>Karakteristikat e intervistave vs. Pyetësorë.</i></p> <p>Tema 18 - Përdorimi i dokumentacionit për mbledhjen e të dhënave <i>Llojet e dokumentacioneve që përdoren për marrjen e të dhënave studimore.</i></p> <p>Seminar 9 - Pyetësorët e vet-administruar</p>	⁽²⁾ fq.98-108 ⁽²⁾ fq.109-116	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
X.	<p>Tema 19 - Vlefshmëria e të dhënave në studim. <i>Madhësitë matëse të vlefshmërisë.</i></p> <p>Tema 20 - Besueshmëria e të dhënave në studim. <i>Burimet e variacionit në njehsimin e ndryshorëve.</i></p> <p>Seminar 10 - Sensitiviteti dhe Specificiteti. Vlera parashikuese pozitive dhe negative.</p>	⁽²⁾ fq.117-134 ⁽²⁾ fq.135-144	Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i>
XI.	<p>Tema 21 - Analiza e të dhënave <i>Kodimi dhe hedhja e të dhënave në kompiuter. Analiza statistikore e të dhënave.</i></p>	⁽²⁾ fq.145-153	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	Tema 22 - Interpretimi i rezultateve <i>Roli i shancit ose gabimi i rastit. Faktorët konfondues.</i> Seminar 11 - Interpretimi i rezultateve	⁽²⁾ fq.153-170	Leksion 1 orë Seminar 1 orë
II.	Tema 23 - Përgjithësimi i rezultateve të studimit <i>Konkluzionet dhe aplikimi i rezultateve të studimit.</i> Tema 24 - Përmbledhje e stadeve të realizimit të kërkimit shkencor. <i>Cikli i jetës së një studimi.</i> Seminar 12 - Stadet e realizimit të kërkimit shkencor.	⁽²⁾ fq.171-174	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Seminar 1 orë
II.	Tema 25/26 - Shkrimi i raportit shkencor. <i>Teknikat e shkrimit të raportit shkencor</i> Seminar 13 - Shkrimi i raportit shkencor.	Variante raportesh shkencorë.	Leksion 2 orë Seminar 1 orë
IV.	Tema 27/28 - Shkrimi i artikujve shkencorë. <i>Teknikat e shkrimit të artikujve shkencorë.</i> Seminar 14 - Shkrimi i artikullit shkencor. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatric Parësor.	Variante artikujsh shkencorë.	Leksion 2 orë Seminar 1 orë Praktikë 5 orë
IV.	Tema 29/30 - Shkrimi i projekt-propozimeve. <i>Teknikat e shkrimit të projekt-propozimeve. Njohja me formularin standart.</i> Seminar 15 - Shkrimi i projekt-propozimeve. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatric Dytësor.	Variante projekt-propozimesh.	Leksion 2 orë Seminar 1 orë Praktikë 5 orë

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshëm është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuar ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuar. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
KONTROLLI I VAZHDUESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi final	Fundi i semestrit	Kapitulli I, II	70 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Temë studimore	30 pikë	Prezantim me gojë	Raportimi i studimit shkencor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<i>*Detyra e kursit</i> - Do të jetë në formën e një teme studimore: studim analitik (kohort apo rast-kontroll). Detyra do të përmbajë të gjitha elementet e temës së diplomës, me përjashtim të faktit që rastet klinike të paraqitura mund të jenë të supozuara, dhe jo të marra nga klinika.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
	5	6	7	8	9	10

LITERATURA	
Literatura bazë e detyruar	(1) 'Epidemiologjia' E.Roshi, G.Byrazeri 2009 (Fakulteti i Mjekësisë - UT) ISBN:978-99943-52-49-4 (2) 'Metodologjia e kërkimit shkencor në shëndetin publik' G.Burazeri, E.Roshi, Z.Shabani 2010 (Fakulteti i Mjekësisë - UT) ISBN:978-99956-48-47-3
Literatura e rekomanduar	o 'Epidemiology' L.Gordis 2010 o 'Survey methods in community medicine' J.H.Abramson 2009

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimin, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penaltete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI VLORË”
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

<p>Karakteristikat e detyrave të kursit</p>	<p><i>Rregullat për paraqitjen e detyrave / projekteve të kursit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">▪ Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në kohën e caktuar. Ato duhet të tregojnë që në paraqitje një stil profesionist.▪ Duhet të jenë të shtypura. Punet me shkrim dore nuk do të pranohen dhe studenti do të vlerësohet automatikisht me 0 pikë.▪ Në punime gjuha duhet të jetë zyrtare, letrare dhe neutrale. Ndalohen rreptësisht përdorimet e zhargoneve të pa argumentuara, shprehjet që rëndojnë etikën profesionale dhe njerëzore, kërcënimet, fyerjet, sharjet, etiketimet, tendencat politizuese, trajtimet jashtë tematikave të kërkuara, etj.▪ Punët duhet të kenë një volum me më tepër se 3 faqe (format A⁴, shkrimi Times New Roman, 12 pt) dhe në faqet e para duhet të jenë të shënuara pa gabime drejtshkrimore: <div data-bbox="646 768 1352 974" style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin: 10px auto; width: fit-content;"><p>Emri i Studentit Titulli i punimit Kursi dhe grupi përkatës i studentit Data e dorëzimit të punimit sipas grafikut të shpallur Emri i instruktorit Numri i faqeve</p></div> <p><i>Elementët e vlerësimit të detyrës së kursit do të përfshijnë:</i></p> <p>Thelbësore:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Respektimin e struktures së punimit shkencor▪ Renditjen e argumenteve akademiko-shkencorë▪ Mënyrat specifike të trajtimit të çështjeve në raport me realitetin shqiptar <p>Ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Ideja e zgjedhur▪ Mënyra e organizimit të punimit▪ Logjika e përdorimit të koncepteve▪ Përputhja me objektivat e programit mësimor▪ Argumentet dhe analiza kritike
--	--